

VENDIM
Nr. 16/2021

PËR MIRATIMIN E FONDIT, PËR FINANCIMIN E PARTIVE
PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET, PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË VITIT
2021

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të neneve 88, pika 1, dhe 180, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Kuvendit nr. 51, datë 27.4.2017,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit, për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet, për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2021, do të jetë në vlerën 130 milionë lekë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 15.2.2021.